



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 01, datë 26.01.2021

PËR
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA FIER, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 5, DATË 29.12.2016,
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 5, datë 29.12.2016 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Fier”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Fier, si dhe referuar Vendimit të Këshillit të Bashkisë Fier Nr. 01 datë 18.01.2021, Këshilli Kombëtar i Territorit,


VENDOSI:

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Fier të miratuar me Vendimin Nr. 5, datë 29.12.2016, të Këshillit Kombëtar të Territorit, të bëhen ndryshime në dokumentin e Rregullores së Planit:

- Pas pikës 3.1 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor shtohet pika 3.1/1: *Rregullat për zhvillimet në sistemet Urban, Bujqësor dhe Natyror;*
- Pas pikës 7.1.2 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor shtohet pika 7.1.2/1: *Rastet për të cilat hartimi i PDV-së nuk është i detyrueshëm dhe/ose i nevojshëm;*
- Në tabelën e treguesve të zhvillimit të njësive strukturore, shtohet njësia strukturore 9/55_1;
- Në pasaportën e njësisë strukturore 9/55 ndryshon sipërfaqja e njësisë.

sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Fier, bashkëlidhur këtij Vendimi.

2. Ngarkohen Bashkia Fier dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të



miratuara.

3. Ngarkohen Bashkia Fier, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË


BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT


LEBIA/EGTA

